

**AKT – THEMELIMI  
I SHOQËRISË TREGTARE  
“SSH” SHPK**

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare’ dhe atij nr.9723, datë 03.05.2007 “Per Qendrën Kombëtare të Biznesit”, me vullnetin tim të lirë unë nënshkruesi,  
I. Z. Skerdi Shkemi shtetas shiptar, i biri i Arben, lindur në Tirane më 07.06.1988, banues në Tirane, Rruga “Mihal Grameno” Shtëpi 166, Tiranë, Shqipëri, me numër karte identiteti I80607071L, vendosa të zhvilloj veprimtari private e cila rregullohet nga kjo kontratë, Akti Themelimi dhe Statuti i saj gjithashtu dhe Legjislacioni në fuqi, si më poshtë vijon:

**NENI 1**

Formohet shoqëria tregtare e emërtuar “SSH” sh.p.k me ortak të vetëm themelues zotin: **Skerdi Shkemi**.

**NENI 2**

Shoqëria do të ketë statusin e nje shoqërie me pergjegjësi të kufizuar dhe do të përballoje humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin e regjistruar.

**NENI 3**

Shoqëria e ka selinë e saj në qytetin e Tiranës, Rruga “Mihal Grameno” Shtëpi 166, Tiranë, Shqipëri. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera, degë e filiale, përfaqësi e agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organeve kompetente edhe jashtë vendit.

**NENI 4**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

**NENI 5**

Shoqëria tregtare do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm (vetëm nëse është i përcaktuar):

Dhenie makinash me qera. Import makinash. Mund te lidhe kontrata shitblerje, perdorimi, shkembimi, sipermarrje apo marreveshje te tjera me kliente, investitore, bashkeinvestitore, operatore dhe administrues te strukturave turistike. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili eshte ne perputhje me Ligjet e republikes se Shqiperise.

**NENI 6**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (Njëqindmijë) lekë dhe përbëhet nga 1 kuotë, nga e cila: I. Z. Skerdi Shkemi zotëron 100% të kuotave.

Ndryshimi i kuotave bëhet nëpërmjet kontributeve në kapital ose me shitblerje.

**NENI 7**

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve të ortakëve, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar që përcakton ligji.

**NENI 8**

Ortaku mund ti shesi kuotat e tij të kapitalit pjesërisht ose tërësisht. Shitja e kuotave, do të bëhet vetëm pasi të ketë marrë vendim asambleja e ortakëve me 100% të votave.

**NENI 9**

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

NENI 10

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- Asambleja e ortakëve.
- Administratori

Fusha e veprimtimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet në statut.

NENI 11

Administrator i shoqërisë "SSH" shpk emërohet Z. Skerdi Shkambi, me afat 5 vjet, nga dita e regjistrimit të shoqërisë në QKB.

NENI 12

Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksioneve financiare do të kryhen në bazë të kritereve të caktuara nga Banka e Shqipërisë. Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale.

NENI 13

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim të ortakut sipas përqindjes në kapital, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës statutore.

NENI 14

Ky akt u përpilua nga ortaku i vetëm i shoqërisë duke shprehur vullnetin e tij të plotë e të lirë. Akti u përpilua me fuqi dhe në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare, për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

***I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

***"SSH" sh.p.k***

***Skardi Shkambi***

*Shkambi Shkambi*

*Emër mbiemër (nënshkrimi)*

U nënshkrua në Tiranë më 16.10.2024.